



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija

XHEMAJL PEÇANI, FILLON DETYRËN E KRYESHEFIT EKZEKUTIV TË SKQZ-së

29.05.2009

Xhemajl Peçani, Koordinator i Terrenit, i zgjedhur në postin e Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së më 19 maj, ka filluar detyrën. Z. Peçani, është me profesion jurist dhe ka punuar në KQZ që prej themelimit. Në takimin e bërë me strukturat dhe punëtorët e SKQZ-së, z. Peçani ka thënë se prioritetet e tij në detyrën e re, do të jenë puna ekipore – profesionale, dhe përgjegjësia. “Zgjedhjet duhet të organizohen në frymë ligjore, dhe SKQZ duhet të mobilizohet në shkallë të lartë në mënyrë që detyrat të realizohen me sukses. KQZ, për herë të parë pas shpalljes së pavarësisë, do t’i organizojë zgjedhjet në mënyrë të pavarur”. Peçani, ka thënë po ashtu se ky do të jetë një test që bashkërisht, duhet ta kalojmë me sukses.